

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQËRISË
Starton SHPK**

THEMELIMI

Neni 1

Ortaket themelues

1.1 Shoqëria **Starton SHPK** themelohet nga **Ortaket si me poshte:**

1. **Znj. Enkelejda Beshiri**, shtetase Shqiptare, lindur me 15.08.1976 ne Tirane, me rezidence Tirane, mbajtese e Pasaportes me numer BA2406210 dhe Nr. Personal H65815060D.
2. **Znj. Elvi Goxhaj** shtetase Shqiptare, lindur me 27.07.1993 ne Tirane, me rezidence Tirane, mbajtese e Pasaportes me numer BC7668008 dhe Nr. Personal J35727063O.

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2

Emërtimi

2.1 Emërtimi i shoqërisë është **Starton**

Neni 3

Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4

Baza ligjore

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5


Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendren Kombetare te Biznesit ("QKB").
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë për një afat të pa percaktuar.

Neni 6

Selia

6.1 Selia shoqërisë është në adresën: Njesia Bashkiake Nr. 2, Rruga Murat Toptani, Qendra e Biznesit "Gjergj Center" Kati 1 – Tirane.



- 6.2 Ortaket e shoqërisë mund të vendosin të hapin degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/ose zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj ose mund ti rregjistrojnë ato ekzistuese sipas ligjeve në fuqi.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashtë saj me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

Neni 7

Emblema. Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemen dhe vulën e saj.

Neni 8

Objekti

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: **“Bar – Kafe, Restorant”**
- 8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

Neni 9

Kapitali

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100'000 Lekë (Njëqind mijë Leke).
- 9.2 Pronesia e kuotave ndahet midis ortakeve si me poshte vijon:
- Znj. Enkelejda Beshiri zoteron 50% te kapitalit te shoqerise e barabarte me 1 kuote, me nje vlere te pergjithshme prej 50'000 Lek (Pesedhjete mijë Lek)
 - Znj. Elvi Goxhaj zoteron 50% te kapitalit te shoqerise e barabarte me 1 kuote, me nje vlere te pergjithshme prej 50'000 Lek (Pesedhjete mijë Lek)
- 9.3 Kapitali është shlyer tërësisht.

Neni 10

Transferimi i pjesëve të kapitalit. Kufizimet.

- 10.1 Kuotat mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me amendimet perkatëse të tij, vetëm pasi të merret aprovimi nga Asambleja e Pergjithshme.
- 10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblese se Pergjithshme.

Neni 11

Rritja e kapitalit

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakët e rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

Neni 12



Zvogëlimi i kapitalit

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Asambleja e Pergjithshme. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblese se Pergjithshme raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme te Shoqërise.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13


Vendimet e Asamblese se Pergjithshme

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Asambleja e Pergjithshme.
- 13.2 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme përfshijnë kryesisht:
- Percaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - Ndryshimin e emërimit të shoqërisë;
 - Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - Prishjen dhe/ose likuidimin e shoqërisë;
 - Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
 - Emërimin ose shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
 - Miratimin e bilancit të shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise së veprimtarisë;
 - Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - Transformimin e shoqërisë në forma të tjera;
 - Miratimi ose konfirmimi i vendimeve dhe veprimeve te Administratorit sipas percaktimeve te nenit 14 te ketij Statuti;
 - Të drejta dhe detyrime të tjera të parashikuara nga legjislacioni tregtar në fuqi.

Neni 14

Administrimi

- 14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblese se Pergjithshme.
- 14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë sipas konfirmimeve dhe udhëzimeve te dhena nga Asambleja e Pergjithshme.
Administratori i shoqërisë është **Znj. Enkelejda Beshiri**, shtetase Shqiptare, lindur me 15.08.1976 ne Tirane, me residence Tirane, mbajtese e Pasaportes me numer BA2406210 dhe Nr. Personal H65815060D.
- 14.3 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët ose ne gjykim personalisht ose me përfaqësim;
 - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
 - Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;



- Përgatitjen e nenshkrimit e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
- Zhvillon veprimtari të tjera të cdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj sipas udhezimeve të Asamblese së Përgjithshme;
- Administratori ka të drejtë për ta përfaqësuar shoqërinë në Shqipëri tek palet e treta, institucione apo entitete publike ose private;
- Te lidhe për dhe në emër të shoqërisë kontrata me pale të treta;
- Te punesoje dhe pushoje punëmarres apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarevajtjen e biznesit në Shqipëri;
- Te përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion banka në emër të saj;
- Vendos mbi transferimin e selisë së shoqërisë;

Administratori për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të tij të parashikuar këtu me sipër, të drejta dhe detyrime të cilat janë parashikuar në legjislacionin tregtar në Republikën e Shqipërisë apo për cdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për biznesin e shoqërisë në Shqipëri do të ushtrohet vetëm pas marrjes së miratimit paraprak të Ortakëve të shoqërisë. Miratimin paraprak i Ortakëve mund të jepet edhe nepermjet emailit të dërguar nga adresat zyrtare të Ortakëve të cilat do të njoftohen shoqërisë 10 dite pas nënshkrimit të këtij Statuti.

14.4 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në castin e revokimit të tij me vendim të Asamblese së Përgjithshme.

Neni 15

Viti financiar

- 15.1 Viti financiar i shoqërisë përpulhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyren e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16


Bilanci. Kontabiliteti.

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të vecanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të vecanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 17

Te Ardhurat. Dividendi

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezerve për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet përkatëse.



17.2 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe Asambleja e Pergjithshme dhe do të pergjigjen deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të pare deri në tre ushtrimoret vijues.

Neni 18

Likuidimi

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendim të Asamblese se Pergjithshme.
- 18.2 Me vendim të Asamblese se Pergjithshme caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Asambleja e Pergjithshme do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likuidimit.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Neni 20


Klauzolë mbyllëse

- 20.1 Ky Statut hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe me fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane më 07.11 .2023

Starton SHPK

Enkelejda Beshiri

Enkelejda Beshiri


Elvi Goxhaj

Elvi Goxhaj
